

Njoftim për përqendrim me të cilin Allwyn International AG, Zvicër, dhe gjashtë persona fizikë do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Next Lotto GmbH, Gjermani (lënda nr. 08-59/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24), më 10.03.2025, dhe plotësuar më 19.03.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim me të cilin Allwyn International AG, me seli të regjistruar në adresën Mühlenplatz 9, 6004, Lucerne, Kantoni Lucerne, Zvicër, dhe gjashtë persona fizikë nga Gjermania, përkatësisht: Johannes Stegmaier, Ravensburg, Gjermani, Winfried Rudi Storz, Weingarten, Gjermani, Daniel Weber, Markdorf, Gjermani, Christian Weber, Markdorf, Gjermani, Dr. Oliver Stefan Storz, Weingarten, Gjermani dhe Hubert Manfred Deutsch, Riedlingen, Gjermani, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Next Lotto GmbH, me seli të regjistruar në adresën Reichenaustrasse 39 A, 78467 Konstanz, Gjermani.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Allwyn International AG është shoqëri e varur 100% i Allwyn AG, një shoqëri holding e themeluar në Zvicër, e cila blen dhe menaxhon pjesë në kompani të industrisë së lojërave dhe është shoqëria mëmë e Grupit Allwyn.

Grupi Allwyn është një operator shumëkombësh i lotarisë me prani të konsiderueshme në Austri, Republikën Çeke, Greqi, Qipro, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Illinois), dhe përfundimisht zotërohet nga Grupi KKCG (KKCG Group).

Grupi KKCG investon në disa fusha biznesi, përfshirë lotari dhe lojëra fati, energji, pasuri të paluajtshme dhe teknologji informacioni.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e operimit të terminaleve të videolotarisë dhe tregun e teknologjisë së informacionit, dhe ka shoqëritë e varura të mëposhtme në Maqedoninë e Veriut:

- CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare Aktivitete të bixhozit dhe basteve;
- Videolotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - Casinos Austria SHPK Shkup, me veprimtari prioritare Aktivitete të bixhozit dhe basteve;
- KINSHIFT SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm Seavus SHPKNJP Shkup), me veprimtari prioritare Programim kompjuterik;
- KINSHIFT ACADEMY SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm SEAVUS QENDRA EDUKATIVE DHE ZHVILLIMORE SHPKNJP Shkup);
- MUSALA SOFT SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare Programim kompjuterik.

PARASHTRUESI i dytë në përqendrimin e planifikuar janë së bashku gjashtë persona fizikë nga Gjermania, përkatësisht:

- Johannes Stegmaier, Ravensburg, Gjermani,
- Winfried Rudi Storz, Weingarten, Gjermani,
- Daniel Weber, Markdorf, Gjermani,
- Christian Weber, Markdorf, Gjermani,
- Dr. Oliver Stefan Storz, Weingarten, Gjermani, dhe

- Hubert Manfred Deutsch, Riedlingen, Gjermani.

Asnjë nga këta persona fizikë nuk është aktiv në tregun e Maqedonisë së Veriut, as drejtpërdrejt, as përmes pronësisë së një shoqërie tregtare.

Next Lotto GmbH, me seli të regjistruar në adresën Reichenaustrasse 39 A, 78467 Konstanz, Gjermani. Ajo është aktive në fushën e shërbimeve online të lotarisë në Gjermani, u mundëson lojtarëve të blejnë biletat e tyre për lojërat e lotarisë online dhe u ofron shërbime të caktuara shitesë.

Next Lotto GmbH nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk është aktive në asnjë mënyrë në tregun e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet si tregu i shitjes së biletave të lotarisë në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të biew nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën. Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

19.03.2025

Shkup